


# Sundimi i Ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE

— dokument tremujor —

korrik-shtator 2023



Instituti  
për  
politikë  
evropiane.  
Shkup



Ky projekt finansohet nga Bashkimi Evropian



# Sundimi i ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE

Përmbledhje tremujore korrik-shtator 2023

## Botues:

Instituti për politikë evropiane - Shkup

## Për botuesin:

Dr. Simonida Kacarska

## Redaktorët:

Dr. Simonida Kacarska  
Dr. Ardita Abazi Imeri

## Autorë:

Ardita Abazi Imeri  
Angela Delevska  
Beba Zhagar  
Julijana Karai

## Përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:


Blerina Starova Zlatku

## Dizajn grafik:

Relativ

Shkup, 2023

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Ndërtojmë urë për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i së drejtës në drejtim të aderimit në BE", i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesi nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Kjo përmbledhje paraqet zhvillimet kryesore në lidhje me sundimin e ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE në Maqedoninë e Veriut për periudhën korrik – shtator 2023. Ai përfshin ndjekjen e bazave të anëtarësimit në BE, duke përfshirë zhvillimet kryesore në funksionimin e institucioneve demokratike, reformën e administratës publike dhe kapitullin 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore.

## Zhvillimet kryesore

- » Komisioni për Çështjet Kushtetuese miratoi propozimin për ndryshime kushtetuese, duke i hapur rrugë shqyrtimit të vazhdueshëm të tij. Më pas, u mbledh një seancë plenare, gjatë së cilës qeveria dhe opozita mbajtën qëndrimet e tyre fillestare. Megjithatë, seanca u ndërpre dhe pritet vazhdim i këtij procesi në periudhën e ardhshme;
- » Mes diskutimeve të gjera rreth ndryshimeve kushtetuese, janë zhvilluar bisedime të fshehta për strategjinë zgjedhore;
- » Skandali i keqpërdorimit të ilaçeve të kancerit ka nxitur zemërim publik në Maqedoninë e Veriut, me thirrje për dorëheqje ministore;
- » Këshilli për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile vazhdoi bojkotin dhe po priste përgjigje nga përfaqësuesit e Qeverisë për plotësimin e kërkesave;
- » Një marrëveshje partneriteti për programën 'Evropa Digjitale (2021–2027)', u nënshkrua në Bruksel midis Maqedonisë së Veriut dhe Bashkimit Evropian;
- » Në korrik, u miratua Strategjia e Reformës në Administratën Publike 2023–2030 me një plan veprimi;
- » Mospërputhjet e perceptuara në përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve dhe dobësitë sistematike të regjistruara në modelin e përzgjedhjes së tyre, arritën kulmin me një mision vlerësimi të punës së Këshillit Gjyqësor nga Bashkimi Evropian;
- » Për të mbështetur parimet e sigurisë dhe transparencës ligjore dhe për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të dispozitave ligjore, duke lehtësuar kështu punën e medias, Gjykata Supreme vendosi një qëndrim parimor për akreditimin dhe lejet e medias për incizim dhe fotografim;
- » Mosmarrëveshjet dhe refuzimi i një kërkesë për rialokimin e fondeve nga Këshilli i Buxhetit Gjyqësor çuan në një grevë të përgjithshme të shërbimeve gjyqësore dhe të prokurorisë publike. Greva është nxitur nga kërkesat për një rritje të pagave prej 78% dhe rivendosjen e shtesave të pagave prej 35%;
- » Gjykata Kushtetuese shfuqizoi Udhëzimin e sapomiruar për Regjistrat e Gjendjes Civile që shtonte rubrikën "kombësia" në certifikatat e regjistratit të lindjeve, martesave dhe vdekjeve, i kontestuar nga ekspertë dhe disa prej partive për ndërhyrje në të dhëna të ndjeshme dhe të mbrojtura;
- » Në shtator, u miratuan ndryshimet e propozuara në Kodin Penal, duke futur dënime më të lehta për veprat penale të shpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar dhe shpërdorimit kriminal;
- » Një propozim-ligj i ri për amnistinë, i cili ka për qëllim lirimin e të burgosurve të dënuar për krime më të lehta, hyri në procedurën parlamentare;
- » U botua Rregullorja që plotëson Rregulloren për vendosjen dhe klasifikimin e personave të dënuar në Institucionet Penitenciare, duke i siguruar kështu grave që vuajnë dënimet me burg të njëjtat të drejta dhe përfitime si burrat;
- » Ndryshimet në Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale u miratuan në korrik, por rishikimet nuk ndryshuan ose fshinë nenin 102 të kontestuar në lidhje me ndalimin e reklamave qeveritare në mediat private;
- » Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar u ndryshua në shtator, duke ulur kështu taksën për materialet e higjienës menstruale nga 18% në 5%, gjë që më pas do të ulte çmimin e tyre.





## Lista e shkurtesave

ASH	Aleanca për Shqiptarët
ASHMAA	Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele
ACCMIS	Sistemi i automatizuar i informacionit për menaxhimin e lëndëve gjyqësore
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
AGJPP	Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë
PTHP	Prokuroria Themelore Publike
ZPTHP	Zyra e Prokurorisë Themelore Publike
PHTHPNKOK	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
KPMD	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
OSHC	Organizatata e shoqërisë civile
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
KE	Komisioni Evropian
KEDNj	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
EPI	Instituti i Politikave Evropiane
ERA	Akademia e së Drejtës Evropiane
BE	Bashkimi Evropian
IRI	Instituti Republikan Ndërkombëtar
IRL	Laboratori i Gazetarisë Hulumtuese
LASHMAA	Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuele
LGBTI	Komunitetet lezbike, homoseksuale, biseksuale, trans dhe interseksuale
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
AIM	Agjencia Informativ Mediatike
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OJQ	Organizata joqeveritare
DULA	Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë
ATO	Agjencia Teknike-Operative Shkup
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RAP	Reforma e Administratës Publike
AMDP	Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
PP	Zyra e Prokurorisë Publike
RM	Republika e Maqedonisë
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
LSDM	Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
SÇE	Sekretariati për Çështje Evropiane
SIGMA	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit
TBE	Traktati për Bashkimin Evropian
SPOGJSH	Sindikata e Punëtorëve të Administratës, Organeve Gjyqësore dhe Shoqatave të Qytetarëve
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
VMRO-DPMNE	Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas
WeBER	Fuqizuesit e Ballkanit Perëndimor për Reformimin e Administratave Publike



# PËRMBAJTJA

<b>Funksionimi i Institucioneve Demokratike .....</b>	<b>6</b>
Zgjedhjet .....	7
Kuvendi .....	8
Qeverisja .....	9
Shoqëria Civile .....	12
Mbikëqyrja civile e sektorit të sigurisë/inteligjencës .....	13
Reforma e Administratës Publike .....	13
<b>Kapitulli 23 .....</b>	<b>15</b>
Funksionimi i gjyqësorit .....	16
Dokumente strategjike .....	16
Organet drejtuese .....	16
Pavarësia dhe paanshmëria .....	18
Llogaridhënia .....	19
Profesionalizmi dhe kompetenca .....	20
Cilësia e drejtësisë .....	21
Efikasiteti .....	22
Lufta kundër Korrupsionit .....	24
Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit .....	24
Prokuroria Publike .....	26
Kudri Ligjor .....	27
Të drejtat themelore .....	29
Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut .....	29
Avokati i Popullit .....	29
Godinat e burgut dhe paraburgimit .....	30
Mbrojtja e të dhënave personale .....	31
Liria e Shprehjes .....	31
Grupet e cënveshme dhe parimi i mosdiskriminimi .....	32
Gjinia .....	34
LGBTI+ .....	35
Romët .....	35

# Funksionimi i Institucioneve Demokratike



# Zgjedhjet

Në fillim të korrikut, ministrat nga Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) dorëzuan letra të kushtëzuara dorëheqjeje. Ata deklaruan se do të jepnin dorëheqjen nga pozitat e tyre nëse Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) voton për ndryshimet kushtetuese. Ky qëndrim u përforcua edhe nga Kryetari i Kuvendit, i cili poashtu dha dorëheqjen. Megjithatë, VMRO-DPMNE refuzoi të pranojë dorëheqjen e Kryetarit dhe vazhdoi të bëjë presion për zgjedhje të parakohshme pa mbështetur ndryshimet kushtetuese.<sup>1</sup>

Kryetari i Aleancës për Shqiptarët (ASH), gjithashtu Kryetari aktual i Komunës së Gostivarit, tha se zgjedhjet e parakohshme të planifikuara për nëntor ose dhjetor të këtij viti nuk janë të këshillueshme. Njëkohësisht, ai beson se ato nuk duhet të zhvillohen në korrik të vitit të ardhshëm, gjatë afatit të rregullt. Argumenti i tij bazohet në besimin se zgjedhjet e rregullta presidenciale duhet të ndodhin në mënyrë ideale në mars ose prill. Mbajtja e zgjedhjeve parlamentare menjëherë pas tyre do të rezultonte në ngarkesa të panevojshme financiare për shtetin.<sup>2</sup>

Mes diskutimeve të gjera rreth ndryshimeve kushtetuese, janë zhvilluar bisedime të fshehta për strategjinë zgjedhore; Një skenar përfshin bashkëpunimin e mundshëm paszgjedhor midis anëtarëve aktualë të koalicionit pro-evropian dhe një partie të re qytetare për të kompensuar humbjet e mundshme të votave. Megjithatë, brenda BDI-së ka besim se veprimet e fraksionit 'Grupi i Zjarrit' nuk do të ndikojnë ndjeshëm tek ata. Nga ana tjetër, ndarje janë shfaqur brenda vetë Grupit të Zjarrit. Kreu i bllokut shqiptar, planifikon të krijojë një lëvizje të re në bashkëpunim me partitë opozitare Besa dhe Alternativa. Në të njëjtën kohë, anëtarët e tjerë preferojnë të trajtojnë çështje brenda partisë së tyre ekzistuese. Ekzistojnë gjithashtu spekulime rreth shfaqjes së emrave të reja politike, veçanërisht duke përfshirë Kryetaren e Qytetit të Shkupit dhe Kryetarin e Komunës së Kumanovës. Përbërja e koalicionit qeverisës pas zgjedhjeve mbetet e pasigurt dhe qëndrimi i ASH dërgon sinjale të përziera.<sup>3</sup>

Në shtator, një ndarje brenda partisë opozitare VMRO-DPMNE u bë e dukshme. Kryetari aktual i partisë u përfshi në një debat publik me ish-kryetarin e partisë dhe ish-kryeministrin. I pari e akuzoi këtë të fundit për bashkëpunim me qeverinë aktuale për të dobësuar partinë. Ky shkëmbim pretendimesh çoi në diskutime midis mbështetësve të tyre përkatës dhe ndikoi në popullaritetin e partisë. Megjithatë, të dyja palët mohuan çdo pretendim bashkëpunimi midis ish-kryetarit të partisë dhe qeverisë aktuale.<sup>4</sup>

1 'Dorëheqjet e BDI-së- taktikë apo mundësi? (Оставките на ДУИ – тактика или прилика?!)', *Vecer.Mk*, 31 korrik 2023, <https://bit.ly/4951fG5>.

2 'Taravari është kundër mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në afatin e rregullt në korrik, vitin e ardhshëm (Таравари е против одржување на парламентарните избори во редовниот термин – во јули, догодина)', *360 Stepeni*, 7 gusht 2023, <https://360stepeni.mk/taravari-e-protiv-odrzhuvane-na-parlamentarnite-izbori-vo-redovniot-termin-vo-juli-dogodina/>.

3 'Në mëngjes për ndryshimet kushtetuese, në pasdite për zgjedhjet (Претпладне за измените, popladne за изборите)', *Deutsche Welle*, 17 korrik 2023, <https://www.dw.com/mk/pretpladne-za-izmenite-popladne-za-izborite/a-66251626>.

4 'Ish-kryeministri i arratisur i Maqedonisë së Veriut i akuzuar për "Marrëveshje të pistë" me qeverinë ', *Balkan Insight- Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ*, 20 shtator 2023, <https://balkaninsight.com/2023/09/20/fugitive-north-macedonia-ex-pm-accused-of-dirty-deal-with-govt/>.

# Kuvendi

Në korrik, dorëheqjet e kushtëzuara të ministrave të BDI-së dolën në qendër të vëmendjes. Partitë qeveritare pretenduan se ishin përmbushur të gjitha kushtet e opozitës për votimin e ndryshimeve kushtetuese. Në të kundërt, opozita pohoi se njoftimi i BDI-së ishte i pasinqertë, duke theksuar se dorëheqjet duhet të ndodhin brenda Kuvendit dhe jo përmes deklaratave nëpër media.

Fokusi kryesor kombëtar mbeti tek ndryshimet kushtetuese, me fillimin e seancës së parë plenare më 18 gusht. Pas seancës, Kryetari i Kuvendit deklaroi se ajo do të rifillonte në një datë të mëvonshme kur të ishte e pranishme shumica e kërkuar.<sup>5</sup>

Një raport i publikuar nga Instituti për Demokraci “Societas Civilis”—Skopje, tregoi se ekziston një nivel relativisht i ulët i cilësisë në lidhje me debatin në Kuvend në këtë mandat dhe se ka hapësirë për përmirësim të ndjeshëm.<sup>6</sup> Sipas raportit, deputetët nga opozita ishin më aktivë në diskutime, duke marrë pjesë në 76% të të gjitha diskutimeve të monitoruara, ndërsa deputetët nga shumica parlamentare morën pjesë në 24%. Pjesa e grave në diskutim është në një nivel të lartë prej 43%. Mbetet në një nivel relativisht të lartë, dhe kjo është pjesëmarrja më e lartë e grave në diskutim krahasuar me mandatet e vëzhguara më parë. Ajo që është problematike është se në 49% të të gjitha diskutimeve të analizuara, pjesëmarrësit nuk kanë dhënë argumente. Në krahasim, 44% e diskutimeve të analizuara kishin argumente të dobëta; domethënë, folësit ofruan një shpjegim të qëndrimeve të tyre që është i pamjaftueshëm për t'u konsideruar një argument i plotë.

Ambasadori spanjoll paraqiti programin dhe përparësitë për punën e Presidencës Spanjolle me Këshillin e Bashkimit Evropian për periudhën korrik-dhjetor 2023 në një seancë të përbashkët të Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian dhe Komisionit për Çështjet Evropiane.<sup>7</sup>

5 ‘Xhaferi ndërpreu seancën për ndryshimin e Kushtetutës, Qeveria nuk gjeti 80 deputetë (Џафери ја прекина седницата за промена на Уставот, власта не најде 80 пратеници)’, *A1 On*, 18 gusht 2023, <https://a1on.mk/macedonia/dzhaferi-ja-prekina-sednicata-za-promena-na-ustavot-vlasta-ne-najde-80-pratenici/>.

6 Vlora Reçica, Aleksandra Jovevska Gjorgjevikj, dhe Nikolla Donev, ‘Raport monitorimi. Nr. 16/2023- Kuvendi nën thjerrëz: Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvend (janar-qershor 2023)’ (Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – Skopje (IDSCS), gusht 2023), <https://idscs.org.mk/en/2023/08/15/Assembly-watch-monitoring-report-on-the-debate-quality-in-the-Assembly-january-june-2023/>.

7 ‘Spanja vazhdon angazhimin e saj për zgjerimin e BE-së (Шпанија продолжува со заложбите за проширување на ЕУ)’, *Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 11 korrik 2023, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-spanija-prodolzuva-so-zalozbite-za-prosiruvane-na-eu.nspix>.



# Qeverisja

Sipas një sondazhi të publikuar nga Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI),<sup>8</sup> vetëm një përqind e qytetarëve i besojnë gjyqësorit dhe prokurorëve publikë. Ndërsa, vetëm gjashtë përqind e qytetarëve besojnë në barazinë para ligjeve në Maqedoni dhe 38 përqind kanë mosbesim të plotë. Varfëria, standardi i ulët dhe çmimet e larta janë në krye të listës si problemet më të rëndësishme me të cilat përballen qytetarët dhe statistikat tregojnë se pothuajse 50 përqind e të anketuarve janë pesimistë dhe presin një situatë ekonomike edhe më të keqe në dy vitet e ardhshme. Lidhur me integrimin evropian të Maqedonisë, ka një rritje në mbështetjen për anëtarësimin në BE krahasuar me sondazhin e fundit nga tetori i vitit të kaluar. 79 përqind e qytetarëve janë për hyrjen e vendit në Bashkimin Evropian, me vetëm 17 përqind kundër.

Qeveria po përgatit një strategji të re për transparencë me një plan veprimi për vitet 2023–2026.<sup>9</sup> Drafti u bë nga grupi i punës i udhëhequr nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe u prezantua në shtator.<sup>10</sup>

Hulumtimi mbi indeksin e transparencës aktive të institucioneve, i cili kryhet rregullisht nga shoqata jo-qeveritare Qendra për Komunikime Civile, tregon se në vitin 2023 si dhe në vitin 2022, qeveria ka nivelin 100 për qind, domethënë publikon të gjitha informacionet e parashikuara nga transparenca aktive.<sup>11</sup> Njëqind për qind transparencë aktive këtë vit mbahet edhe nga Ministria e Mbrojtjes. Transparenca e përgjithshme aktive e qeverisë dhe ministrive është përmirësuar me 86 përqind këtë vit. Në të njëjtën kohë, një nivel i lartë i transparencës aktive është regjistruar në një numër të madh ministrish, si Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.<sup>12</sup>

Në fund të korrikut, një automjet që lidhej me Zëvendëskryeminstriin e Parë u dogj,<sup>13</sup> një akt i dënuar ashpër nga qeveria.<sup>14</sup> Incidenti ngriti pyetje në lidhje me saktësinë e deklaratës së pasurisë së Grubit, pasi ai e kishte shënuar makinën e tij si një 'Citroen Xara' me vlerë 1,000 euro dhe jo 'Audi', siç është raportuar.<sup>15</sup> Kjo ngjarje u dënua nga figura të ndryshme politike dhe opozita bëri thirrje për një hetim të prokurorisë publike për fshehjen e mundshme të pasurisë dhe instalimin e paligjshëm të dritave të posaçme, të cilat mund të bëhen vetëm nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Si përgjigje, Prokuroria Publike në

8 Center for Insights in Survey Research, 'National Survey of North Macedonia | April – May 2023' (International Republican Institute-IRI, 10 July 2023), <https://www.iri.org/resources/national-survey-of-north-macedonia-april-may-2023/>.

9 'Njoftim nga takimi me një pjesë të grupit të punës për përgatitjen e Strategjisë së re të Transparencës me plan veprimi (2023-2026) (Известување од состанокот со дел од работната група за izgotvuвање на novata Strategija za transparentnost со Акциски план (2023-2026))', *Faqja zyrtare në Facebook e Sllavica Grkovska, Zëvendëskryeminstre në krye të Politikave të Qeverisjes së Mirë*, 6 korrik 2023, <https://bit.ly/3Mj03VQ>.

10 'Grkovska: Të dhënat u përkasin qytetarëve, funksionerët duhet të sigurojnë transparencë të plotë të institucioneve (Грковска: Податоците им припаѓаат на граѓаните, носителите на функции да обезбедат целосна transparentnost на институциите)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 11 shtator 2023, <https://vlada.mk/node/34412>.

11 'Indeksi i Transparencës Aktive 2023', *Qendra për Komunikime Civile*, 10 korrik 2023, <https://bit.ly/3QgH9zM>.

12 'Qeveria me 100% Transparencë Aktive edhe në vitin 2023 (Владата со 100% активна Transparentnost и во 2023 година)', *Kanal 5*, 10 korrik 2023, <https://kanal5.com.mk/vladata-so-100-aktivna-transparentnost-i-vo-2023-godina/a590498>.

13 'Pretendohet se makina private e Artan Grubit, e cila është regjistruar me një emër tjetër, u dogj (Се тврди дека е опожарен приватниот автомобил на Artan Grubi, кој пак се води на друго име)', *Meta.Mk*, 22 korrik 2023, <https://meta.mk/se-tvrdi-deka-e-opozharen-privatniot-avtomobil-na-vicepremierot-grubi-koj-pak-se-vodi-na-drugo-ime/>.

14 'Siguria është përparësia kryesore, veproni pa vonesë për të pastruar shpejt dhe plotësisht rastin e dhunës në të cilën automjeti i përdorur nga zëvendëskryeminstri i parë Grubi u vu në zjarr (Безбедноста е врвен приоритет, постапување без одлагање за брзо и целосно расчистување на случајот на насилство во кое е запалено возилото кое го користел првиот вице-премиер Grubi)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 23 korrik 2023, <https://vlada.mk/node/33991>.

15 'Rishikimi i detajuar-Artan Grubi (Детален преглед- Artan Grubi)', *Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit*, <https://bit.ly/3FA60K0>.

Shkup kërkoi dokumentacion në lidhje me blerjen dhe pronësinë e automjetit. Grubi më vonë sqaroi se makina nuk ishte e tij dhe i kërkoi falje pronarit dhe fqinjëve të tij.<sup>16</sup>

Skandali i keqpërdorimit të ilaçeve të kancerit ka nxitur zemërim publik në Maqedoninë e Veriut, me thirrje për dorëheqje ministër ministrave.<sup>17</sup> Polemika u shfaq pak para se Kuvendi i Maqedonisë së Veriut të miratonte ndryshime të diskutueshme në Kodin Penal, të kritikuara se cenojnë përpjekjet antikorrupsion.<sup>18</sup> Përfaqësues nga organizatat joqeveritare (OJQ) kanë paralajmëruar se këto ndryshime mund të çojnë në skadimin e shumë çështjeve të profilit të lartë që përfshijnë ish-udhëheqës politikë dhe zyrtarë që përballen me akuza për “keqpërdorim të detyrës” dhe “ndërmarrje kriminale”.<sup>19</sup> Partitë e opozitës dyshojnë se është në pritje një marrëveshje me ish-kryeministrin për të siguruar mbështetje për një ndryshim kushtetues, që mund të ndikojë në situatën e tij ligjore. Udhëheqësi i VMRO-DPMNE-së gjithashtu kritikoi ndryshimet e shpejta legjislative, duke sugjeruar se ato mbrojnë zyrtarët qeveritarë në largim, nga ndjekja e mundshme penale.<sup>20</sup> Përveç kësaj, reagimet e delegacionit të BE-së në vend dhe Komisionit Evropian (KE) u nxitën nga këto ndryshime për shkak të miratimit të tyre të shpejtë dhe për shkak të keqpërdorimit të flamurit evropian.<sup>21</sup>

Në fillim të korrikut, shqyrtimi dypalësh për Kapitullin 27-Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike u krye në Bruksel, një nga dy shqyrtimet më të gjata. Në shqyrtimin para KE-së, përmes 75 prezantimeve, u paraqit situata në fushat e legjislacionit horizontal, menaxhimit të mbetjeve, cilësisë së ujit, natyrës, kimikateve, ndotjes industriale dhe ndryshimeve klimatike.<sup>22</sup> Në mes të korrikut u krye edhe shqyrtimi shpjegues për Klasterin 5 “Burimet, bujqësia dhe kohezioni”,<sup>23</sup> dhe në shtator u zhvilluan edhe takimet e shqyrtimit për kapitullin 15-Energjia, kapitulli 21-Rrjetet Trans-Evropiane, dhe Klasteri 6, kapitulli 30-Marrëdhëniet e Jashtme.<sup>24</sup>

Gjatë gushtit 2023, zhvillimet e dukshme përfshinin publikimin nga KE të raportit të shqyrtimit për Klasterin 1<sup>25</sup> dhe prezantimin e raportit nga “Grupi i të Dymbëdhjetëve”, një panel i mbledhur nga qeveritë franceze dhe gjermane, me titull “Lundrim në det të hapur: Reformimi dhe Zgjerimi i BE-së në shekullin 21”.<sup>26</sup> Lidhur me të parën, u tregua se kuadri ligjor është kryesisht i vendosur, por zbatimi ka nevojë për

16 ‘Djegia e “Audi-së” në duart e një prokurori: Ai do të kontrollojë nëse Grubi është pronari dhe kur është blerë (Запаленото „ауди“ во рацете на обвинител: ќе проверува дали сопственик е Груби и кога е купено)’, *Mkd.Mk*, 23 korrik 2023, <https://bit.ly/3FytyyT>.

17 ‘Pretendimet për keqpërdorim të trajtimit të kancerit trondisin Maqedoninë e Veriut’, *Balkan Insight- Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulmtuese*, 4 shtator 2023, <https://balkaninsight.com/2023/09/04/cancer-treatment-misuse-allegations-rock-north-macedonia/>.

18 ‘Pretendimet për keqpërdorim të trajtimit të kancerit trondisin Maqedoninë e Veriut’.

19 ‘Qeveria ka propozuar ndryshime në Kodin Penal që zvogëlojnë dënimet me burg për zyrtarët (Владата предложи измени на Кривичниот законик со кој се намалуваат затворските казни за функционерите)’, *Zëri i Amerikës*, 6 shtator 2023, <https://mk.voanews.com/a/vladata-predlozhi-izmeni-na-krivichniot-zakonik-so-ko-%D1%98-se-namaluvaat-zatvorskite-kazni-za-funkcionerite/7256668.html>.

20 ‘Presidenti i Maqedonisë së Veriut u nxit të bllokojë ndryshimet e papritura të ligjit penal’, *Balkan Insight- Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulmtuese*, 7 shtator 2023, <https://balkaninsight.com/2023/09/07/north-macedonias-president-urged-to-block-sudden-criminal-law-changes/>.

21 ‘Komisioni Evropian është i shqetësuar për ndryshimet e Kodit Penal (Европската комисија е загрижена поради измените на Кривичниот законик)’, *Slobodnaevropa.Mk*, 12 shtator 2023, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32589801.html>.

22 ‘Shukova nga Brukseli: Ne jemi të gatshëm të marrim pjesën tonë të përgjegjësisë (Шукова од Брисел: Подготвени сме да го преземеме нашиот дел од одговорноста)’, *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 3 korrik 2023, <https://vlada.mk/node/33792/>.

23 ‘Shqyrtimi shpjegues për Klasterin 5, “Burimet, bujqësia dhe kohezioni” filloi në Bruksel (Во Брисел започна објаснувачкиот скрининг за Кластер 5, “Ресурси, земјоделство и кохезија”)’, *Faqja zyrtare e Sekretariatit për Çështje Evropiane*, 17 korrik 2023, <https://www.sep.gov.mk/post/?id=13480>.

24 ‘Takimi shqyrtues për Kapitullin 15 - Energjia dhe Kapitulli 21 - Rrjetet Trans-Evropiane ka filluar në Bruksel (Во Брисел започна скрининг состанокот за Поглавје 15 – Енергетика и Поглавје 21 – Трансевропски мрежи)’, *Faqja zyrtare e Sekretariatit për Çështje Evropiane*, 14 shtator 2023, 15, <https://www.sep.gov.mk/post/?id=13525>.

25 ‘Raporti i Shqyrtimit të Maqedonisë së Veriut Klasteri 1 – Themelet (Komisioni Evropian, 20 korrik 2023)’, [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/MK%20Cluster\\_1%20Draft%20screening%20report\\_external%20version.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/MK%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf).

26 ‘Raporti i shqyrtimit të Maqedonisë së Veriut Klasteri 1 – Themelet’.

përforsim. Nevojitet përmirësim i veçantë në fushën e gjuhës së urrejtjes, korrupsionit dhe konfiskimit të pasurive kriminale, zbatimit më aktiv dhe të azhurnuar të strategjisë për të luftuar korrupsionin dhe vullnetit më të madh politik në lidhje me reformën e administratës publike. Këshillave u jepen gjithashtu mesazhe të drejtpërdrejta që gjyqtarët dhe prokurorët publikë të respektojnë parimin e pavarësisë gjyqësore, të promovojnë transparencën dhe të parandalojnë dhe sanksionojnë format e ndërhyrjes së brendshme dhe të jashtme në sistemin e drejtësisë. Nga ana tjetër, propozimi i ekspertëve franko-gjermanë i kushton rëndësi të madhe ruajtjes së sundimit të ligjit si një parim kushtetues i paprekshëm, thelbësor për funksionimin efektiv të Bashkimit Evropian (BE) dhe si parakusht për anëtarësim. Raporti përmban disa rekomandime për të rritur kapacitetin e BE-së për të mbrojtur dhe përforcuar sundimin e ligjit. Këto rekomandime përfshijnë forcimin e masave të kushtëzimit buxhetor dhe rafinimin e nenit 7 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE) përmes një procesi të rishikimit të traktatit. Zhvendosja e propozuar drejt mundësitë të votimit me shumicë të kualifikuar për vendimmarrje në një gamë të gjerë fushash të politikave brenda BE-së është e rëndësishme së njëjtë.

Qeveria vazhdoi përpjekjet e saj diplomatike për të promovuar ndryshimet kushtetuese gjatë gjithë periudhës raportuese. Përfaqësuesit qeveritarë u angazhuan në një fushatë bindëse përmes vizitave dhe daljeve në media, duke kërkuar të bindin qytetarët se ndryshimet nuk janë të dëmshme dhe nuk duhet të pengojnë rrugën e integritetit të vendit në BE.<sup>27</sup> <sup>28</sup> Kryeministri paraqiti propozimin për ndryshime kushtetuese gjatë një seance të Komisionit për Çështje Kushtetuese në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut. Qeveria shqyrtoi dhe miratoi propozimin më 18 korrik 2023, dhe hyri në procedurën parlamentare më 25 korrik 2023.<sup>29</sup> Kuvendi i Maqedonisë së Veriut filloi një debat dhjetë-ditor mbi propozimin e qeverisë për të ndryshuar kushtetutën, duke kërkuar mbështetjen e dy të tretave të të gjithë 120 ligjvënësve që propozim-ligji të miratohet.<sup>30</sup> Për më tepër, Kryeministri iu drejtua seancës plenare në Kuvend, ku morën pjesë 73 deputetë mbështetës, duke theksuar të ardhmen evropiane të vendit.<sup>31</sup>

Gjatë një interviste me Agjencinë Informativë Mediatike (MIA), Kryeministri pohoi stabilitetin e koalicionit qeveritar, edhe në dritën e zhvillimeve të fundit brenda BDI-së dhe shfaqjen e Lëvizjes Demokratike. Ai shprehu besim në stabilitetin e koalicionit dhe parashikoi se partitë pro-evropiane do të mbeten të përkushtuara ndaj ndryshimeve kushtetuese. Ai theksoi se të gjitha partitë parlamentare dhe deputetët e njohën rëndësinë e këtij momenti historik dhe nevojën për të marrë vendimin e duhur për të formësuar rrugën evropiane të vendit.<sup>32</sup>

27 'Petrovska: Ndryshimet kushtetuese nuk shkaktojnë dëm, koha e çmuar në procesin e anëtarësimit në BE nuk duhet të humbet (Петровска: Уставните измени не нанесуваат штета, не смее да се губи драгоцено време во процесот на пристапување кон ЕУ)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 17 korrik 2023, <https://vlada.mk/node/33921>.

28 'Kovačevski për AIM: Nuk do të ketë kushte të reja, është koha për vendime në interes të shtetit (Ковачевски за МИА: Нови условувања нема да има, време е за државнички одлуки)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 6 gusht 2023, <https://vlada.mk/node/34087>.

29 'Kovačevski Komisionit për Çështje Kushtetuese: Ne kemi një shans unik për të vazhduar rrugën evropiane, gjuha dhe identiteti maqedonas janë të mbrojtura, para deputetëve ka vendim në interes të shtetit (Ковачевски на Комисијата за уставни прашања: Имаме неповторлива шанса за продолжување на европскиот пат, македонскиот јазик и идентитет се заштитени, пред пратениците е државничка одлука)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 25 korrik 2023, <https://vlada.mk/node/34001>.

30 'Kuvendi i Maqedonisë së Veriut fillon seancën për ndryshim kushtetues', *Balkan Insight- Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Hulumtuese*, 18 gusht 2023, <https://balkaninsight.com/2023/08/18/north-macedonia-Assembly-starts-session-on-constitutional-change/>.

31 'Tema e ditës me Kryeministrin dhe Kryetar të LSDM-së, Dimitar Kovačevski (Тема на денот со премиерот и претседател на СДСМ, Димитар Ковачевски)', *Sitel TV*, 3 tetor 2023, <https://sitel.com.mk/tema-na-denot-so-premierot-i-pretседatel-na-sdsm-dimitar-kovačevski-0>.

32 'Kovačevski për AIM: Koalicioni është stabil, pres një debat parlamentar të frytshëm mbi një vendim jopartiak, në të mirën e shtetit (Ковачевски за МИА: Коалицијата е стабилна, очекувам плодна парламентарна debata за натpartиска, државничка одлука)', *Maktel.Mk*, 7 gusht 2023, <https://bit.ly/498APmH>.

Gjatë gjithë periudhës raportuese, Maqedonia e Veriut ishte dëshmitare e vizitave të shumta nga zyrtarë të nivelit të lartë që përfaqësonin Shtetet Anëtare të BE-së dhe SHBA-në, duke pohuar mbështetjen e tyre të fortë për fillimin e negociatave të anëtarësimit. Rëndësia e zbatimit me sukses të ndryshimeve kushtetuese ishte një temë e përsëritur gjatë këtyre vizitave. Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme u angazhuan në takime të shumta me udhëheqës dhe homologë nga vendet anëtare të BE-së në forume të ndryshme, duke përfshirë Forumin Strategjik të Bledit, Forumin e Konektivitetit të Tiranës dhe Procesin e Berlinit.

Në bashkëpunimin rajonal, Kryeministri maqedonas u takua me Kryeministrin shqiptar për të diskutuar Procesin e Berlinit, integrimin në BE dhe forcimin e marrëdhënieve dypalëshe si anëtarë të Organizatës së Traktatit të Veri-Atlanti (NATO). Ata theksuan nevojën për angazhim të palëkundshëm për të arritur anëtarësimin në BE deri në vitin 2030.<sup>33</sup> Për më tepër, më 16 korrik 2023, Kryeministri dhe Kryeministri serb prezantuan një sistem të integruar elektronik të pagesës rrugore, duke mundësuar që pagesa rrugore të paguhet në kufi me një pajisje të vetme midis Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.<sup>34</sup>

Në njëzet e dy vjetorin e Marrëveshjes së Paqes së Ohrit, Zëvendëskryeministri i Parë reflektoi mbi rëndësinë e saj, duke theksuar se si ajo shënoi një epokë të re për Maqedoninë e Veriut. Marrëveshja vendosi bazat për paqen, unitetin, barazinë dhe demokracinë e bazuar në konsensus. Pavarësisht dyshimeve dhe sfidave fillestare, mbizotëroi angazhimi për të kapërcyer paragjykimet dhe diskriminimin në favor të një të ardhmeje të përbashkët të bazuar në vlerat e identitetit të ndërsjellë.<sup>35</sup>

## Shoqëria Civile

Këshilli për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile vazhdoi bojkotin dhe po priste përgjigje nga përfaqësuesit e Qeverisë për plotësimin e kërkesave.

Në gusht, Sekretariati për Çështje Evropiane (SÇE) filloi konsultime me OSHC-të,<sup>36</sup> duke theksuar nevojën për transparencë dhe gjithëpërfshirje. SÇE u angazhua për diskutime të vazhdueshme me OSHC-të për të zhvilluar udhërrëfyes që përfshijnë kontribute nga të gjithë aktorët shoqërorë drejt reformave politike dhe institucionale, me qëllim të përgatitjes së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim të plotë në BE deri në vitin 2030. OSHC-të mirëpritën fillimin e konsultimeve të udhërrëfyesit. Ata shprehën gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar në mënyrë aktive në diskutime konstruktive, duke siguruar të dhëna me shkrim që do të formësojnë ndjeshëm përmbajtjen e këtyre dokumenteve.<sup>37</sup>

33 'Kovačevski-Rama: Procesi i Berlinit dhe iniciativat e tjera rajonale sigurojnë integrim më të shpejtë evropian të vendeve të rajonit (Kovačevski - Rama: Берлинскиот процес и останатите регионални иницијативи обезбедуваат побрза евроинтеграција на земјите од регионот)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 6 korrik 2023, <https://vlada.mk/node/33818>.

34 'Kovačevski-Brnabić: Ballkani i Hapur jep rezultate, me një tag të përbashkët për pagesën rrugore, lehtësohet udhëtimi për qytetarët e Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë (Kovačevski-Brnabić: Отворен Балкан дава резултати, со заеднички tag за патарини, олеснето патувањето за граѓаните на Северна Македонија и Србија)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 16 korrik 2023, <https://vlada.mk/node/33912>.

35 'Mesazhi i Nënkryetarit të Parë të Qeverisë, Artan Grubi me rastin e 22 vjetorit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (Пораката на првиот потпретседател на Владата, Артан Груби по повод на 22 годишнината на Охридскиот рамковен договор)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 13 gusht 2023, <https://vlada.mk/node/34122>.

36 'Marić: Kontributi i sektorit civil është kyç për përparimin e suksesshëm në procesin e integritimit evropian (Мариќ: Придонесот на граѓанскиот сектор е клучен за успешен напредок во евроинтегративниот процес)', *Faqja zyrtare e Sekretariatit për Çështje Evropiane*, 24 gusht 2023, <https://www.sep.gov.mk/post/?id=13493>.

37 'Marić: Kontributi i sektorit civil është kyç për përparimin e suksesshëm në procesin e integritimit evropian (Мариќ: Придонесот на граѓанскиот сектор е клучен за успешен напредок во евроинтегративниот процес)', *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 24 gusht 2023, <https://vlada.mk/node/34219>.



## Mbikëqyrja civile e sektorit të sigurisë/inteligjencës

Agjencia Teknike-Operative Shkup (ATO) aktualisht është pa drejtor, pasi ish-drejtori përfundoi mandatin e tij pesë-vjeçar në shtator dhe nuk ka të drejtë të rizgjidhet. Ish-drejtori fillimisht caktoi një konferencë shtypi për 7 shtator, ditën kur mbaroi mandati i tij, por ajo u anulua më vonë pa shpjegim. Emërimi i drejtorit të ri kërkon një shumicë prej dy të tretave të votave në Kuvend, dhe ndërsa 21 individë kanë aplikuar për pozicionin, ende nuk është arritur një vendim.

Deputet nga partia VMRO-DPMNE, ngriti shqetësime se agjencitë nuk kanë siguruar prova të mjaftueshme për të konfirmuar nëse qytetarët po monitorohen duke përdorur të ashtuquajturin softuer malicioz. Përveç kësaj, ka pasiguri në lidhje me prodhimin e softuerit brenda Maqedonisë së Veriut që potencialisht mund të keqpërdoret për ndjekje të paligjshme të komunikimit.<sup>38</sup>

## Reforma e Administratës Publike

Në fillim të muajit, në Bruksel u nënshkrua Marrëveshja e Partneritetit midis Maqedonisë së Veriut dhe BE-së në programin “Evropa Digjitale (2021–2027)”. Marrëveshja u nënshkrua nga Ministri i Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës dhe përfaqësues nga Komisioni Evropian.<sup>39</sup>

Më 11 korrik, u miratua Strategjia për RAP 2023–2030 me një plan veprimi, dhe ajo u prezantua në shtator nga Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës në bashkëpunim me Mbështetjen për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit (SIGMA) në kuadër të ngjarjes “Administrata publike moderne, efikase dhe e digjitalizuar: Vizioni 2030 - ofrimi i shërbimeve publike me cilësi më të lartë për qytetarët dhe sektorin privat”.<sup>40</sup> Strategjia parashikon përfshirjen e përfaqësuesve nga sektori civil në Sekretariatit e Reformës së Administratës Publike (RAP) dhe, nëse është e nevojshme, në Këshillin e RAP. Formimi i përbërjes së re të Sekretariatit është duke u zhvilluar, i cili në të vërtetë është një rekomandim nga Monitorimi i RAP i EPI-t në kuadër të Projektit Fuqizimi i Ballkanit Perëndimor për Reformimin e Administratave Publike (WeBER).<sup>41</sup> Strategjia gjithashtu citon gjetjet nga Monitorimi i RAP i EPI-t, i cili, në fakt, përfaqëson veprim mbi një rekomandim tjetër nga monitorimi që gjetjet e OSHC-ve të referohen siç duhet në dokumentet qeveritare.<sup>42</sup>

38 ‘Nikoloski: Ne nuk kemi marrë një mohim të besueshëm se qytetarët nuk po monitorohen me softuer malicioz në vend (Nikoloski: Не добивме кредибилен демант дека во земјава не се следат граѓани со малициозен софтвер)’, *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 18 shtator 2023, <https://360stepeni.mk/nikoloski-ne-dobivme-kredibilen-demant-deka-vo-zemjava-ne-se-sledat-gragani-so-malitsiozen-sofтвер/>.

39 ‘Ministri Azir Aliu në Bruksel nënshkroi Marrëveshjen e Partneritetit në Programin «Evropa Digjitale (2021–2027)» me BE-në (Министерот Азир Алиу во Брисел го потпиша Договорот за партнерство во програмата „Дигитална Европа (2021–2027)”, *Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 2 korrik 2023, <https://vlada.mk/node/33790>.

40 ‘U prezantua Strategjia e re për reformën e administratës publike (Презентирана новата Стратегија за reforma на јавната администрација)’, *Meta.Mk*, 20 shtator 2023, <https://meta.mk/prezentirana-novata-strategija-za-reforma-na-javnata-administracija/>.

41 Julijana Karai dhe Angell Mojsovski, ‘Monitorimi kombëtar RAP 2021/2022 – Maqedonia e Veriut’ (Instituti i Politikave Evropiane- Shkup, 10 korrik 2023), <https://www.par-monitor.org/north-macedonia-par-monitor-2021-2022/>.

42 ‘Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2023–2030 me plan veprimi 2023–2026 (Стратегија за reforma на јавната администрација 2023 – 2030 со Акциски план 2023 – 2026)’ (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, korrik 2023), 22, <https://www.mioa.gov.mk/mk-MK/news/strategija-za-reforma-na-javnata-administracija-2023-2030-so-akciski-plan.nspk>.

Në korrik, u mbajt një seancë dëgjimore publike për propozim-ligjin për Shërbimin e Menaxhmentit të Lartë.<sup>43</sup> Sistemi i shërbimit të menaxhmentit të lartë duhet të sigurojë arritjen e dy qëllimeve kryesore:

1. Menaxherët e lartë profesionistë, të përzgjedhur përmes një procedure të hapur dhe meritokratike (bazuar në kompetencat e tyre profesionale);
2. Vendosja e marrëdhënieve të besimit dhe përgjegjesisë midis personave të zgjedhur dhe të emëruar politikisht dhe menaxherëve të lartë.

Në të njëjtën kohë, vazhdon puna për ligjet e reja për punonjësit e sektorit publik dhe nëpunësit administrativë me mbështetjen e SIGMA, që planifikohet të miratohet në pako me ligjin.<sup>44</sup>

Në shtator, u mbajt seanca e gjashtë e Këshillit për Koordinim dhe Monitorim të procesit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur 2021–2023. Seanca shqyrtoi dhe diskutoi idetë dhe sfidat e marra nga grupet e punës për krijimin e një propozimi të angazhimeve për planin e ri të veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2024–2026.<sup>45</sup>

Në shtator, u mbajt një diskutim publik mbi draftin e Strategjisë së Transparencës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (2023–2026). Strategjia synon të lidhë dhe harmonizojë politikat tashmë të miratuara që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, synojnë të përmirësojnë transparencën e institucioneve dhe të japin drejtime të reja për përmirësimin e transparencës së institucioneve.<sup>46</sup>

Deri në fund të periudhës raportuese, Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës zhvilloi një takim pune me Zëvendëskryeministrin përgjegjës për Politikën e Qeverisjes së Mirë dhe Kryetarin e Këshillit Kombëtar për Transformimin Digjital të Shoqërisë dhe përfaqësuesit e Këshillit Kombëtar, ku diskutuan për digjitalizimin dhe Ligjin për Sigurinë Kibernetike dhe Transformimin Digjital dhe krijimin e Agjencisë Digjitale.<sup>47</sup>

43 'Kritika e Ligjit për Shërbimin e Menaxhmentit të Lartë, ndikimi politik vështirë se mund të shmanget (Критики за Законот за висока раководна служба, тешко може да се избегне политичко влијание)', *Meta.Mk*, 21 shtator 2023, <https://meta.mk/kritiki-za-zakonot-za-visoka-rakovodna-sluzhba-teshko-mozhe-da-se-izbegne-politichko-vlijanie/>.

44 'Ligjet për punonjësit në sektorin publik dhe për zyrtarët administrativë në procedurën qeveritare do të barten me një flamur evropian (Законите за вработени во јавниот сектор и за административни службеници во владина процедура, ќе се носат со европско знаменце)', *24 Info*, 4 tetor 2023, <https://bit.ly/3FGDgzb>.

45 'U mbajt sesioni i gjashtë i Këshillit për koordinimin dhe monitorimin e procesit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur 2021–2023 (Одржана шестата седница на Советот за координација и следење на процесот на Партнерството за отворена власт 2021–2023 година)', *Uebfaqja zyrtare e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës*, 28 shtator 2023, <https://www.mioa.gov.mk/mk-MK/news/odrzana-sestata-sednica-na-sovetot-za-koordinacija-i-sledene-na-procesot-na-partnerstvoto-za-otvorena-vlast-2021-2023-godina.nspх>.

46 'Strategjia e transparencës së qeverisë- një vizion për një shtet me kulturë të transparencës dhe qeverisjes së mirë për rritjen e besimit të qytetarëve (Стратегија за транспарентност на Владата – визија за држава со култура на транспарентност и добро владеење за зголемена доверба на граѓаните)', *Civil Media*, 11 shtator 2023, <https://civilmedia.mk/strategjia-za-transparentnost-na-vladata-vizija-za-drzhava-so-kultura-na-transparentnost-i-dobro-vladeene-za-zgolemena-doverba-na-graganite/>.

47 'Aliu: Me krijimin e Agjencisë Digjitale, ne përcaktojmë vizionin për t'u bërë një shtet anëtar i BE-së (Алиу: Со создавањето на дигиталната агенција, ја определуваме визијата да станеме земја членка на ЕУ)', *AIM - Agjencia Informative Mediatike*, 19 shtator 2023, <https://shorturl.at/dfmZ9>.

# Kapitulli 23



# Funksionimi i gjyqësorit

## Dokumente strategjike

Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Gjyqësor 2023-2027 pret ende për t'u miratuar Shqyrtimi dhe rishikimi i tij nga institucionet përkatëse shtetërore është aktualisht në proces.

## Organet drejtuese

Gjatë periudhës raportuese tremujore, u bënë përpjekje për të plotësuar pozita të lira brenda Këshillit Gjyqësor, me dy anëtarë që do të zgjidhen nga gjyqësori (një nga Gjykata Supreme dhe një nga Rrethi i Apelit të Shkupit, përfshirë gjykatat administrative). Megjithatë, ky proces u përball me mospërputhje dhe shqyrtim publik, duke minuar besueshmërinë e institucionit. Është për t'u veçuar se procesi i përzgjedhjes së kandidatëve filloi pasi një gjyqtar dhe kryetari i Gjykatës Themelore të Kavadarit ngritën kundërshtime dhe morën miratimin e shumicës.<sup>48</sup> Listat përfundimtare të kandidatëve përfshinin dy të nominuar nga Gjykata e Apelit e Shkupit dhe zona zgjedhore e gjykatave administrative dhe një i nominuar nga zona zgjedhore e Gjykatës Supreme.<sup>49</sup> Para finalizimit të listave, Këshilli Gjyqësor pezulloi procedurën, duke përmendur shqetësime mbi kompetencën profesionale dhe performancën e një kandidati në zonën zgjedhore të Gjykatës Supreme.<sup>50</sup> Ky pezullim ka ndodhur një ditë para përcaktimit të listës së kandidatëve, duke ngritur pyetje në lidhje me mosveprimin e mëparshëm të Këshillit Gjyqësor për këtë çështje.<sup>51</sup> Për më tepër, vendimi për ndërprerjen e procedurës nuk u deklarua publikisht, duke lënë arsytet e pezullimit të pazbuluara për publikun.<sup>52</sup>

48 Kandidatura e gjyqtarit Lazar Nanev fillimisht nuk u pranua nga Komisioni për përgatitjen e listave të kandidatëve pas shpalljes për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, për shkak të dokumenteve të dorëzuara në mënyrë të pasaktë, rregullat e të cilës thuhet në vetë thirrjen, në përputhje me Ligjin për Këshillin Gjyqësor. Konkretisht, kandidati Lazar Nanev nuk dorëzoi dokumentet origjinale për vjetërsinë, si dhe certifikatën e orëve të përfunduara të trajnimit në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, por kopje. Së bashku me kundërshtimin që ka paraqitur, ka paraqitur edhe provat origjinale, si dhe shpjegimin dhe komunikimin me e-mail lidhur me arsytet e dorëzimit të kopjeve gjatë dorëzimit të dokumenteve. Në seancën e zhvilluar për këtë çështje, u vu re një mospërputhje e sjelljes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, kur bëhet fjalë për “formalizmin” e tyre në lidhje me pranimit të kundërshtimit të plotësimin e dokumenteve të listuara në mënyrë taksative të kërkuara për kandidim për anëtar të Këshillit, pasi pak muaj më parë Këshilli Gjyqësor pranoi kandidatë që nuk kishin paraqitur dokumente origjinale. Konkretisht, disa nga anëtarët mbetën të mendimit se pavarësisht faktit se ligji përcakton se cilat dokumente duhet të paraqesë kandidati, nuk ishte e nevojshme, sepse Këshilli Gjyqësor kishte të dhëna për secilin gjyqtar në aspektin e vjetërsisë, për të cilat komisioni është në dijeni dhe të cilat janë pjesë përbërëse e dosjeve të secilit gjyqtar, kështu që nuk duhet të kërkohen. Nga ana tjetër, anëtarët e tjerë besojnë se përkundër faktit se Këshilli Gjyqësor është i njohur me të dhënat që kërkohen të dorëzohen gjatë aplikimit për një thirrje specifike, çdo kandidat është ende i detyruar ta bëjë këtë, sepse është një detyrim ligjor. ‘Këshilli Gjyqësor e pranoi aplikimin e parregullt të Nanevit, pas ndërprerjes së procedurës për shkarkimin e Georgievit dhe pa problem i vendosi dy gjyqtarët në listën për anëtarët e rinj (Судскиот совет му ја прифати неправилната апликација на Нанев, откако вчера ја запре постапката за разрешување на Георгиев и без проблем ги стави двајцата судии на листа за нови членови)’, *Sakam Da Kazam*, 5 korrik 2023, <https://sdk.mk/index.php/makedonija/sudskiot-sovet-mu-ja-prifati-nepravilnata-aplikatsija-na-nanev-otkako-vchera-ja-zapre-postapkata-za-razreshuvane-na-georgiev-i-bez-problem-gi-stavi-dvajtsata-sudii-na-lista-za-novi-chlenovi/>; ‘Raport për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor: janar-korrik 2023) (Извештај од следење на работата на Судскиот совет: јануари-јули 2023)’ (Instituti për të Drejtat e Njeriut- Shkup, gusht 2023), <https://bit.ly/3ZuDLpr>.

49 Pas pranimit të kundërshtimit nga gjyqtari Lazar Nanev, listat e kandidatëve u përcaktuan me shumicë votash. Kështu, për Qarkun e Apelit dhe gjykatat administrative të Shkupit, kandidatët për anëtarë të Këshillit ishin Antoineta Dimovska dhe Lazar Nanev, dhe për rrethin zgjedhor të Gjykatës Supreme, kandidat për anëtar të Këshillit ishte gjyqtari Naqe Georgiev ‘Njoftimi nga Sesioni i 448-të i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Соопштение од 448-та седница на Судскиот совет на Република Северна Македонија)’, *Faqja Zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut*, 5 korrik 2023, <https://bit.ly/469MnUI>.

